



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primjenic / Prodato Received / Delivery	24.06	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKAMBICK	3704/2022		115	

Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.450/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.450/2022 të datës 13.05.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] kundër Ministrisë së Financave, Punëve dhe Transfereve-Thesari i Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.450/2022 e datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari i Kosovës, sipas njoftimit të datës 14.03.2022 ka shpallur konkursin me datën 29.03.2022 deri më datën 06.04.2022 për katër(4) pozita: Zyrtar i lartë për Alokime me nr.ref.RN00008524; Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Borgjit Publik me nr.ref.RN00008522; Zyrtar i Lartë i Thesarit me nr.ref.RN00008525 dhe Zyrtar i Lartë Financiar i Pagesave me nr.ref.RN00008528. Ankuesja ka aplikuar për 4 pozitat dhe Njësia e burimeve Njerëzore e Thesarit të Kosovës me datën 13.04.2022 pas fazës së verifikimit paraprak, ankuesja ka hyrë në listën e kandidatëve që i ka plotësuar kriteret e konkursit lëvizje brenda kategorisë e cila është njoftuar përmes SIMBNJ-së. Sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar ankuesja është renditur si në vijim:

Zyrtar i Lartë Financiar me 71.40 pikë, është radhitur e treta(3);
Zyrtar i Lartë i Thesarit me 69.40 pikë, është radhitur e treta(3);
Zyrtarë i lartë për Menaxhimin e borgjit Publik me 27.00 pikë, është radhitur e dyta (2) dhe
Zyrtar i Lartë për Alokime me 30 pikë, është radhitur e dyta(2).

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 13.05.2022 me numër protokollit 2772/2022, me pretendimet ankimore kundër komisionit të vlerësimit për konkursin e shpallur me datën 29.03.2022 deri më datën 06.04.2022 për katër(4) pozita: Zyrtar për Alokime me nr.ref.RN00008524; Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Borgjit Publik me nr.ref.RN00008522; Zyrtar i Lartë i Thesarit me nr.ref.RN00008525 dhe Zyrtar i Lartë Financiar i Pagesave me nr.ref. nr.ref.RN00008528.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 19.05.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje ne ankesë në Thesarin e Kosovës/MFPT, ndërsa Këshilli ka pranuar shkresat e lëndës nga organi i punësimit me datën 27.05.2022 me numër protokollit 3085/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2772/2022 të datës 13.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit për pozitë Zyrtar i Lartë për Alokime i datës 29.03.2022-06.04.2022 me nr. reference RN00008524; Njoftim për listën e ngushtë e datës 13.04.2022; Njoftimi i datës 21.04.2022 renditja e kandidatëve që i plotësojnë kriteret për listën e shkurtër; Njoftimi i datës 22.04.2022 për listën përfundimtare; Njoftimi i datës 29.04.2022 për kandidatin fitues; Kopja e konkursit për pozitën Zyrtar i lartë për menaxhimin me borgjit publik e datës 29.03.2022-06.04.2022 me nr.ref.RN00008522; Njoftim i datës 13.04.2022 me nr.107 për listën e ngushtë; Njoftim i datës 22.04.2022; Njoftim i datës 29.04.2022 me nr.135 për kandidatin fitues; Kopja e konkursit për pozitën Zyrtar i lartë i thesarit i datës 29.03.2022-06.04.2022 me nr.reference RN00008525; Njoftim i datës 21.04.2022 me nr.128 për plotësimin e kriterëve për përfshirje në listën e shkurtër; Njoftim për listën e ngushtë e datës 13.04.2022 me nr.118; Njoftim i datës 22.04.2022 sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar; Njoftim për kandidatin fitues i datës 29.04.2022 me nr.137; Kopja e konkursit për pozitën Zyrtar i lartë financiar i pagesave i datës 29.03.2022-06.04.2022 me numër reference RN00008528; Njoftim i datës 13.04.2022 me numër 115 ; Njoftim i datës 21.04.2022 me numër 126 për listën e shkurtër; Njoftimi i datës 22.04.2022 për vlerësimin e rezultateve përfundimtare; Njoftim për kandidatin fitues i datës 29.04.2022; E-mail zyrtar i datës 10.05.2022; E-mail zyrtar i datës 06.05.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 27.05.2022 me numër protokollit 3085/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/202; Vendimi i datës 07.04.2022 me nr.14/2022 për themelimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitat: Zyrtar i lartë i thesarit dhe Zyrtar i lartë financiar i pagesave; Njoftim për listën e ngushtë i datës 13.04.2022; Njoftim i datës 21.04.2022 me nr.128 për plotësimin e kriterëve për listën e ngushtë; SIMBNJ renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 22.04.2022; Njoftimi i datës 22.04.2022 për vlerësimin e rezultateve përfundimtare; Njoftimi i datës 29.04.2022 për kandidatin fitues; Njoftim për listën e ngushtë me nr.115 i datës 13.04.2022; Njoftimi i datës 21.04.2022; SIMBNJ –Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën Zyrtar i lartë financiar i pagesave; njoftim i datës 22.04.2022; Njoftim për kandidatin fitues me nr.138 të datës 29.04.2022; Vendimi i datës 07.04.2022 me nr.13/2022 për themelimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitat: Zyrtar i lartë për menaxhimin e bordit publik dhe Zyrtar i lartë për alokime; Njoftim për listën e ngushtë i datës 13.04.2022; Njoftim i datës 21.04.2022; Njoftim për kandidatin fitues i datës 29.04.2022; SIMBNJ-Renditja përfundimtare e e kandidatëve; Njoftim për listën e

ngushtë i datës 13.04.2022; Njoftim i datës 21.04.2022; Njoftim i datës 22.04.2022; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 29.04.2022; SIMBNJ-Renditja përfundimtare e kandidatëve; **Aplikacioni** [redacted] i datës 05.04.2022; Diploma Master e datës 08.08.2018 e lëshuar nga Kolegji UBT Prishtinë; Diploma bachelor e datës 19.12.2012 e lëshuar nga Kolegji UBT Prishtinë; Kopja e Letërnjoftimit; Akt emërimi i datës 24.07.2015; Çertifikatë e datës 24.12.2017; Çertifikatë e datës 12.04.2017; Çertifikatë e datës 12.11.2016; Çertifikatë e datës 10.11.2011; Çertifikatë e datës 15.04.2011; Çertifikatë e datës 15.01.2011; Çertifikatë e datës 07.07.2009; Çertifikatë e datës 03.02.2011; Çertifikatë e datës 06.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës; Diploma e shkollës së mesme 07.06.2008; Referencë e datës 04.03.2015 e lëshuar nga NTSH REMO.COM; Referencë e datës 28.03.2015; Vërtetim i datës 27.03.2015; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 07.02.2019; Vërtetim i datës 05.04.2022; Vërtetim i datës 08.04.2022; Aplikacioni i datës 05.04.2022 për [redacted] Akt emërimi i datës 06.03.2019; Diploma Master e datës 11.12.2018 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diploma bachelor e datës 27.09.2015 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina; kopja e letërnjoftimit ; Çertifikatë e datës 18.07.2019; Çertifikatë e datës 19.01.2016; Kontratë e punës e datës 04.06.2022; Kontratë e punës e datës 26.06.2018; Vërtetim i datës 23.11.2018; Referencë e datës 12.01.2021 ; Vendimi i datës 21.11.2021; Vendimi i datës 19.08.2019; Letër reference i datës 22.11.2008; Referencë e datës 05.11.2015; Rekomandim i datës 24.07.2018; Rekomandim; Rekomandim; Informatë e datës 25.11.2022; Vendimi i datës 26.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Përgjigje në kërkesë e datës 07.10.2021; Çertifikatë e datës 05.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; Vërtetim i datës 12.04.2022; Aplikacioni i datës 01.04.2022 për M.K; Diploma Master e datës 28.12.2022 me nr.232 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma Bachelor e datës 16.06.2011 me nr.1825 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Diploma e shkollës së mesme e datës 24.05.2002; Letër rekomandim e datës 28.07.2010; Letër rekomandim i datës 07.10.2019; Vërtetim i datës 15.09.2005; Vërtetim i datës 01.11.2019; Vërtetim i datës 04.06.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Çertifikatë e datës 24.09.2021; Çertifikatë e vitit 2017; Çertifikatë e datës 08.09.2015; Çertifikatë e datës 18.01.2013; Çertifikatë e datës 29.05.2018; Çertifikatë e datës 16.11.2007; Çertifikatë e datës 08.12.2010; Vërtetim i datës 14.06.2021; Çertifikatë e datës 28.03.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetim i datës 23.03.2022; Aplikacioni i datës 05.04.2022 për [redacted] Akt emërimi i datës 04.03.2020; Diploma Master e datës 11.12.2018 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diploma Bachelor e datës 17.09.2015 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Kopja e letërnjoftimit ; Çertifikatë e datës 18.07.2019; Çertifikatë e datës 20.07.2016; Kontratë e datës 04.06.2018; Vërtetim për përvojën e punës e datës 23.01.2021; Referencë e datës 12.10.2021; Vendim i datës 16.11.2021; Vendimi i datës 19.08.2019; Letër reference e datës 22.11.2016; Referencë e datës 05.11.2015; Rekomandim i datës 24.07.2018; Rekomandim Informat e datës 25.11.2021; Vendim i datës 26.11.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Përgjigje në kërkesë e datës 07.12.2021; Çertifikatë e datës 05.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore Mitrovicë; Vërtetim i datës 17.04.2022; Aplikacioni i datës 05.04.2022 për A.S; Diploma Master e datës 24.01.2017 me nr.1078 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diploma bachelor e datës 31.10.2013 me nr.3623 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Akt emërimi i datës 11.04.2012; Diploma për kryerjen e shkollës së mesme e datës 11.06.2007; Çertifikatë e datës 12.03.2021; Çertifikatë e

datës 29.01.2017; Çertifikatë e datës 12.10.2016; Çertifikatë e datës 23.04.2015; Raportim financiar i datës 26.01.2013; Çertifikatë e muajit dhjetor 2017; Çertifikatë e datës 14.09.2012; Çertifikatë e datës 30.07.2012; Çertifikatë e datës 23.07.2012; Çertifikatë e datës 08.05.2012; Çertifikatë e datës 31.08.2010; Letër rekomandimi i datës 08.07.2015; Kopja e letërnjoftimit; Letër rekomandimi i datës 11.04.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 15.01.2022; Vendim për pushime të lehonisë i datës 17.08.2020; Vërtetim i datës 10.02.2022; Vërtetim i datës 07.04.2022; Çertifikatë e datës 06.04.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; E-mail zyrtar i datës 16.05.2022 dhe e-mail zyrtar i datës 10.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e palejuar, **SEPSE**:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesari i Kosovës më datë 29.04.2022 ka publikuar njoftimin përfundimtar për kandidatët fitues për Zyrtar i Lartë Financiar me 71.40 pikë, është radhitur e treta(3); Zyrtar i Lartë i Thesarit me 69.00 pikë, është radhitur e treta(3); Zyrtarë i lartë për Menaxhimin e Borgjit Publik ka marrë 27.00 pikë është radhitur e dyta(2) dhe Zyrtar i Lartë për Alokime me 30 pikë është radhitur e dyta(2).

Ankuesja kundër këtij procesi të pranimit nuk ka sjell asnjë dëshmi me të cilën dëshmohet që kundër këtij procesi ka bërë ankesë të brendshme në njësinë përgjegjëse siç parashihet me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual"*, ndërsa ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj siç parashihet me paragrafin 6 të këtij neni.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet"*, si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankesave, mbi këtë bazë ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, po ashtu

ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.450/2022, datë 24/06/2022

Sabile AVDYLI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses,
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

